



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjerenë Më/Dana 29 - 03 - 2024 vit/god.			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednosë
01-	110	105-	307



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, dhe neni 36 paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën: 28.03.2024, miraton këtë:

## V E N D I M

**për shpalljen në diskutim publik draft rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të bizneseve në Komunën e Vitisë**

1. Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik draft rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të bizneseve në Komunën e Vitisë.
2. Propozimi për shqyrtim publik i Draft Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë do të jepet në shqyrtim publik nga data 01.04.2024, deri me datën 30.04.2024, Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik. Gjithashtu në formën të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së shqyrtimit publik në Zyrën e Drejtorisë së Inspeksionit tek Shtëpia e Kulturës së Komunës së Vitisë, Zyra Nr.08, kati i dytë si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në emalin adresën [Faton.Ahmeti@rks-gov.net](mailto:Faton.Ahmeti@rks-gov.net). Dokumenti gjendet në web faqen e Komunës së Vitisë, [kk.rks-gov.net/viti](http://kk.rks-gov.net/viti)
3. Debatit publik do të mbahet me datën 06.05.2024 në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.
4. Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.
5. Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për Draft Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë.
6. Ky vendim hynë në fuqi ditën e publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Komisionit për hartimin e rregullores;
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

**DRAFT RREGULLORE PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË  
SUBJEKTEVE TË BIZNESIT NË KOMUNËN E VITISË**

**Mars 2024**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, pika h të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 50 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës paraqet këte:

## **DRAFT RREGULLORE PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË SUBJEKTEVE TË BIZNESIT NË KOMUNËN E VITISË**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJTHSHME**

#### **Qëllimi**

##### **Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe të aktiviteteve tjera: hoteleri, zejtari dhe shërbime tjera të organizimit në territorin e komunës së Vitisë.

##### **Neni 2**

Subjektet e biznesit, në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

##### **Neni 3**

3.1 Orari i punës nënkupton periudhën kohore fillimin dhe mbarimin e punës.

3.2 Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet dhe koha e pushimit apo edhe rasteve tjera të jashtë zakonshme.

### **II PËRKUFIZIMET**

Fjalet dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore në vijim:

Lokale Afariste – nënkupton objektin apo hapësiren punuese-sherbyese ku ushtrohet ndonjë veprimtari afariste.

Person Juridik – nënkupton Shoqërin Aksionare, Shoqërin me përgjegjesitë Kufizuar, Ndermarrjet publike, organizatën dhe asocacion tjetër të rexhstruar.

Person Fizik – nënkupton individin ose personin fizik si pronari I ndërmarrjes së rexhstruar si biznes individual.

Inspektor - personi zyrtar me autorizime dhe përgjegjësi të veqanta i cili zbaton mbikëqyrjen inspektuese të afarizmit te subjekteve të biznesit.

Periudha verore – nënkupton periudhen e vitit prej 01/04 deri më 31/10.

Periudha dimërore – nënkupton periudhen prej 01/11 deri më 30/03.

Vikend – nënkupton periudhen prej të premtës në mbremje, të shtunën dhe dielën.

Festa Zyrtare – ditët e festive sipas ligjit mbi festat zyrtare.

### III. Orari i punës

#### Neni 4

Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjes verore dhe dimërore, në intervale kohore:

- a. periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator të vitit;
- b. periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars të vitit.

#### Neni 5

5.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në **Veprimtari zeytare:**

- 5.1. periudha verore, prej orës 8:00 deri në orën 20:00;
- 5.2. periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 19:00.
- 5.3 Të dielave dhe festave zyrtare nuk punojnë

5.2. **Gjellëtoret dhe qebaptoret** punojnë çdo ditë pune:

- 5.2.1 periudha verore, prej orës 6:00 - 23:00;
- 5.2.2 periudha dimërore prej orës 7:00 - 23:00.

Ditën e fundjavës (të dielën) dyqanet zeytare nuk do të punojnë, përveç: Furrat e bukës, gjellëtoreve, qebaptoreve, salloneve të ondulimit, floktoreve, autolarjeve.

#### Neni 6

6.1. Orari i punës në **vetëshërbime, supermarkete dhe dyqane ushqimore**, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 7:00 – 23:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 – 22:00.

6.2. Orari i punës në **dyqanet tregtare të tekstilit, dyqanet e këpucëve, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake “teknikës së bardhë” dhe veprimtarive të tjera jo ushqimore**, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 7:00 – 21:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 20:00.

Të dielave dhe ditëve festive zyrtare nuk punojnë.

6.3 **Barnatoret Farmaceutike** do te punojnë:

- a. periudha verore, prej orës 7:00 – 00:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 23:00.

6.3.1 Barnatoret farmaceutike private te cilat operojne ne qytetin e Vitisë mund te operojne edhe pas ketij orari të përcaktuar, e nese kerkesat dhe nevoja e tregon, keto barnatore jane te obliguara të mbajne kujdestari dhe ate së paku nga nje Barnatore. Orarin e kujdestarise do të hartojne vete barnatoret farmaceutike dhe do te dorëzohet tek Drejtoria e Inspeksionit dhe i njeiti orar do te jete i shpallur në ambientet e QKMF – Viti, nga ku qytetaret do ti marrin informatat e nevojshme. Orari i kujdestarisë do të caktohet sipas alfabetit. Nëse barnatoret së bashku me SHFK, apo shoqaten e tyre nuk e caktojnë orarin e kujdestarisë, te njejtin do ta bejë Inspektorati dhe si tille duhet të respektohet.

6.4 **Barnatoret bujqesore** do te punojnë prej ores 8.00 deri më 18.h.

6.4.1 Përjashtimisht jashtë këtij orari mund të punojnë në sezonën e mbjelljeve, korrje shirjeve si dhe diteve te vikendit

6.5. Të dielave dhe diteve të festive zyrtare nuk punojnë.

6.6. Organizatat e biznesit, sipas pikës 1 të këtij, që veprojnë në periferi të qytetit, në ditën e fundjavës (të dielën), mund të punojnë me orar të zgjatur edhe pas orës 12:00, me pëlqim të veçantë të lëshuar nga Sektori i Ekonomisë dhe Zhvillimit në Drejtorisë së Financave.

#### Neni 7

7.1. Orari i punës në **depot e artikuljve ushqimorë, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit**, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 8:00 - 20:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 18:00.

7.2. Ditën e fundjavës (të dielën) dhe gjatë ditëve të festave, depot nuk punojnë.

7.3. Orari i punës në **ndërmarrjet ndërtimore (ndërtimi i lartë)**, do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 7:00 - 18:00.
- b. periudha dimërore, prej orës 8:00 - 17:00.

Ditën e fundjavës (të dielën) dhe gjatë ditëve të festave, ndërtimi I lartë nuk punojnë.

7.4. Ndërmarrjet ndërtimore, (ndërtimi i lartë) në raste të jashtëzakonshme, për shkak të natyrës së punëve, me leje të posaçme, të cilën e lëshon Drejtoria e Financave, mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00 si dhe për punë gjatë ditëve të diela.

7.5 **Bizneset prodhuese** (orari i punës) nuk kanë kufizime dhe mund të punojnë deri sa nuk bien në kundërshtim me ligjin mbi zhurmen dhe ligjin mbi sigurim publike.

#### Neni 8

8.1 Orari i punës në **kafene** do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 7:00 – 00:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 08:00 – 23:00.

8.2. Orari i punës në **hotele, motele dhe restorante** është i njëjtë në të dy sezonet dhe fillon prej orës: 7:00 - 00:00.

8.3. Përjashtim nga pika 2 e këtij neni do të ketë, sepse mund të punojnë më gjatë se orari i paraparë i punës, por jo më shumë se deri në orën 03:00 të mëngjesit. Me kushte që të mos bie ndesh me ligjin për siguri publike dhe ligjin e mbrojtjes nga zhurma. Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë, 10 € për orë pune.

8.4. Veprimtarive të lartpërmendura në pikën 2 të këtij neni, nuk iu lejohet shërbimi për mysafirë jashtë objektit pas orës 00:00.

#### Neni 9

9.1. Orari i punës në **kafe - bare dhe diskoklube**, është i njëjtë për të dy sezonet, fillon në orën 20:00 dhe mbaron në orën 03:00 (të mëngjesit).

9.2. Orari i punës për **klubet e natës** është i njëjtë në të dy sezonet, fillon prej orës 23:00 dhe mbaron në orën 5:00 (të mëngjesit).

9.3. Orari i punës për **internet - kafe, video lojra dhe bastore** fillon në orën 8:00 dhe mbaron në orën 00:00.

#### Neni 10

10.1 Pikat e shitjes së **derivateve të naftës** mund të punojnë pa ndërprerë në dy periudhat e llogaritjes së kohës sipas sezoneve.

10.2 Restorantet, kafiterit, shitoret ushqimore që janë nën menagjimin e pikave të shitjes së karburanteve mund të punojnë sipas orarit të përcaktuar për pikat e shitjes së derivateve të naftës.

#### Neni 11

11.1 **Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe palestrat sportive** punojnë pa kufizime.

11.2 Orari i punës për **pishina të hapura** është nga ora 10h deri në ora 20.00h.

11.3 Orari i punës për organizimet e ndermarra nga **Organizatat JO-Qeveritare(OJQ), subjektet fetare, subjektet politike**, ndonjë institucion apo të ngjajshme, mund të zgjatet orari deri në orën 02.00h, vetëm nëse aktiviteti ka qëllim kulturor, social, humanitarë apo të ngjajshme. Në këto rrethana zgjatja e orarit të aktiviteteve mund të bëhet pa leje përkatëse dhe pa pagesë të taksës për zgjatje të orarit të aktivitetit, por vetëm me njoftim tek organet e rendit dhe sigurisë publike.

11.4 **Ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet në pronësi të partneritetit publiko privat**, do të punojnë sipas orarit të përcaktuar veror ose dimëror dhe se në raste kur kërkohet nevojë e intervenimeve dhe sanimit të dëmeve apo për interesat e qytetarëve do të punojnë pa ndonjë kufizim.

#### Neni 12

Veprimtarive të parapara në nenet 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje gjatë orarit të punës, nuk iu lejohet t'u prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria. Gjithëmonë duke u bazuar në ligjin për siguri publike dhe ligjin për mbrojtje nga zhurma.

#### Neni 13

13.1. Orari i punës për **tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve** është:

**a. periudha verore, prej orës 6:00 – 19:00.**

**b. periudha dimërore, prej orës 7:00 – 18:00.**

13.2. **Tregu i gjelbërt** do të punojë gjatë se mërkurës në Pozheran dhe gjatë të Enjtës në Viti.

13.3. **Tregu i kafshëve** punon të Mërkurën në Pozheran, të enjtën në Viti.

#### Neni 14

Orari i punës në **Institucionet financiare dhe institucione të ndryshme të pagesave, zyret që ofrojnë shërbime juridike, kompanitë e sigurimeve** do të jete prej 08.00h - 17.00h dhe diteve të diela dhe pushimi.

#### Neni 15

15.1. Orari i punës në **ordinanca dhe klinika private** do të jetë i njëjtë në të dy sezonet, fillon në orën 7:00 dhe mbaron në orën 22:00.

15.2. Në raste urgjente, të dielave dhe gjatë festave shtetërore, mund të punojnë edhe jashtë orarit të paraparë sipas paragrafit 15.1.

#### Neni 16

Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë, dhe atë:

**16.1 Taksa për zgjatje të orarit për një natë 10€**

**16.2 Taksa për zgjatje mujore për një muaj 100€**

## Neni 17

### Zgjatja e orarit të punës:

Për zgjatje të orarit të punës subjektet e biznesit duhet të parashtrorjnë kërkesë një ditë më herët në ditet zyrtare të punës.

Kriterët dhe dokumentet e nevojshme për aplikim për zgjatje të orarit të punës janë:

- a) Plotësimi I formularit për zgjatje të orarit të punës
- b) Çertifikata e biznesit (kopje)
- c) Dokument identifikues i pronarit të biznesit ose personit të autorizuar (kopje)
- d) Pëlqimi për plotësimin e kushteve minimale, teknike sanitaro-higjenike për ushtrimin e veprimtarisë biznesore nga Inspeksioni I tregut dhe ai sanitarë (kopje)
- e) Pagesa e takses për zgjatje të orarit të punës varesisht nga tarifa sipas nenit 16.
- f) Drejtoria në raste të veqanta mbanë të drejtën e kërimit të dokumenteve shtesë sipas nevojës apo rastit konkret.

## Neni 18

Cdo dhënje pëlqimi për zgjatje të orarit të punës Drejtoria e Financave: një kopje të pëlqimit duhet të dergoj tek Inspeksioni i Tregut dhe Shërbimit Policor të Kosovës – Stacionit në Viti.

## Neni 19

19.1. Organizatat e biznesit shërbyese – argetuese, mund ta zgjasin orarin e punës me rastin e festave, të parapara me Ligjin për festat zyrtare, deri në orën 02:00 (të mëngjesit).

19.2. Për të gjitha rastet e parapara në pikën 1 të këtij neni, nuk paguhet taksa shtesë.

## Neni 20

Nëse ndonjë nga organizatat e biznesit dëshiron të punoj ditën e diel dhe të ketë pushim në ndonjërin nga ditët e tjera të javës, atëherë ai biznes është i obliguar që me shkresë zyrtare ta njoftojë drejtorinë e Inspeksionit, konkretisht Inspektorët e Tregut.

## III. DISPOZITAT NDËSHKUESE

### Neni 21

Të gjitha organizatat e biznesit do të gjobiten për kundërvajtje, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 të kësaj rregulloreje, si më poshtë:

- a. persona juridikë ..... 100 - 200€**  
**b. persona fizikë ..... 50 - 100€**

Të gjitha organizatave të biznesit tek të cilat brenda një viti aplikohen dy dënime, atëherë dënimet tjera do të jenë për të gjitha veprimet në kundërshtim me nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 të kësaj rregulloreje, si më poshtë:

- a. persona juridikë ..... 500 - 1000€**  
**b. persona fizikë ..... 250 - 500€**

**Neni 22**

Të gjitha organizatat e biznesit të cilat marrin leje për orar të zgjatur të punës, nëse nuk e përfillin kodin afarist dhe rrezikojnë sigurinë e qytetarëve, do t'u merret leja e punës e lëshuar nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit - Sektori i Ekonomisë.

**IV. DISPOZITAT KALIMTARE**

**Neni 23**

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Sektori i Inspeksionit të Tregut, Sektori i Financave dhe organet e rendit.

**Neni 24**

Të gjitha organizatat e biznesit janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj rregulloreje, në afatin tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes së kësaj Rregulloreje në fuqi.

**Neni 25**

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja 01-110/05-734 të dates 10.07.2019 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.

**Neni 26**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 dite nga data e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

Propozues: Kryetari i Komunës së Vitisë  
Sokol Haliti

---